



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QYTETIT TIRANË

Nr. 4176 Prot.

Tiranë, më 30.11. 2017  
(1. utemi referojuni në rast përgjigje)

NJOFTIM

Në zbatim të Udhëzimit të ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr.38, datë 06.10.2015 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar", Ju njoftojmë se për fazën e parë të konkurimit duhet të dorëzoni vetëm me shërbim postar në adresën e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, Rruga : "Jeronim De Rada", Tiranë, dokumentacionin e plotë si më poshtë :

1. Curriculum Vitae, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Raporti mjeko-ligjor (i tre muajve të fundit dhe i detyrueshem).
3. Deklaratë për gjendjen gjyqësore, sipas Shtojcës 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
4. Vërtetimi i qëndrës së banimit (i detyrueshëm).
5. Fotokopje të librezës së punës (nqs ka qënë ose janë në marrëdhënie pune).
6. Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe të vërtetimit të listës së notave të studimeve të larta (Cikli i I + II dhe DIND) (i detyrueshëm).
7. Fotokopje të Licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit. (i detyrueshëm vetëm për personat të cilët kanë detyrimin ligjor për ta dhënë këtë provim sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar).
8. Fotokopje të certifikatave të trajnimeve (paraqiten kopje te certifikatave të akredituara nga MAS dhe ato jashtë vendit).
9. Fotokopje e dëshmimeve të shkallëve të kualifikimit.
10. Fotokopje të noterizuar të dëshmivë të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor).
11. Fotokopje të noterizuara të dëshmisë së njohjes së gjuhës /ve të huaja.

12. Botime, kumtesa dhe publikime në fushën e edukimit. Kopje të faqes së parë ku të identifikohet titulli dhe njësia publikuese.

13. Deklaratë nga kandidati për autorizimin e Njesisë Arsimore Vendore, Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumentave të paraqitura, sipas Shtojcës 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

**14. Kërkesë me shkrim për të gjithë aplikantët, të cilët titullin në diplomë e kanë me dy profile (psh Histori – Gjeografi, Bio – Kimi, etj), duke specifikuar profilin për të cilin do aplikojnë dhe që më pas do të testohen me shkrim dhe do të renditen në listën përfundimtare.**

Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentat e detyrueshëm si më sipër, s'kualifikohet, nga të gjitha fazat e konkurrimit.

Kandidatët të cilët janë pjesë e listës përfundimtare të portalit “Mësues për Shqipërinë 2016” dhe që dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e tyre në testim, duhet të paraqesin në Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, Rruga : “Jeronim De Rada”, Tiranë, një kërkesë, ku të përcaktojnë se dëshirojnë të rifuten në testim për të përmirësuar rezultatin e testimit me shkrim.

Të gjithë kandidatët, të cilët janë pjesë e listës përfundimtare të portalit “Mësues për Shqipërinë 2016” dhe që nuk dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e tyre në testim, nuk duhet të paraqesin asnjë kërkesë apo dokumentacion tjetër në Drejtorinë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, pasi ata janë automatikisht pjesë e listës së portalit.

**Dokumentacioni për aplikim apo kërkesa** për t'u rifutur vetëm në testim për të përmirësuar rezultatin e testimit (për kandidatët që janë pjesë e listës përfundimtare “Mësues për Shqipërinë 2016”), duhet të paraqitet vetëm me shërbim postar në adresën e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, Rruga : “Jeronim De Rada”, Tiranë.

Afati i pranimit të dokumentacionit për aplikim apo kërkesës për tu rifutur vetëm në testim për të përmirësuar rezultatin e testimit, do të jetë **deri në datën 22.12.2017.**



Në datë 04.01.2018 në mjediset e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit Tiranë, **Rruga : "Jeronim De Rada", Tiranë**, do të shpallen listat e kandidatëve të kualifikuar ose jo dhe pikët përkatëse të dosjes.

Nga data 04.01.2018 – 08.01.2018 të gjithë kandidatët e skualifikuar apo ata që nuk janë të bindur për vlerësimin e dosjes mund të bëjnë një kërkesë me shkrim në sekretarinë e DART për t'u riparë dosja e tyre.

DREJTOR

Arjola BYZYKA

